

VENDIM
Nr. 954, datë 29.12.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 374, DATË 11.6.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN
E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË
MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN
E BUJQËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 374, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Fondet kundërparti të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave, në shumën 130 517 500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda muajit mars të vitit 2015.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. AZHBR-ja mund të realizojë disa herë, brenda muajit mars të vitit 2015, procedurën e pranimit dhe të vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve.”.

c) Në pikën 5, fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Me këto fonde të financohen investimet për:”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

